

Bismilahirr-rrahmanirr-rrahim

Përkthimi i

Fjalimit të Xhumasë

i Kalifit të V-të të Xhematit Islamik Ahmedia,

Hazret Mirza Masrur Ahmedit

mbajtur në Qendrën e Xhematit 'Baitus-Subuh' të Frankfurtit në Gjermani, më

22 dhjetor 2006

Hazuri e filloi fjalimin e tij duke thënë se këto ditë në Vendet e Perëndimit ka një valë të fortë opozite kundër Islamit. Disa flasin haptazi, teksa të tjerët paraqiten si ndihmës e dashamirës të Islamit, por edhe ata me zhdërvjelltësi i vënë në dukje të metat e mësimëve të Islamit ose thonë që ato mësimë janë të pa aplikueshme në ditët tona. Është gjithashtu edhe një klasë tjetër e këtyre kundërshtarëve të cilët i sulmojnë mësimet e Islamit të shtyrë thjeshtë nga ndjenjat e tyre anti fetare. Ata e mohojnë ekzistencën e Zotit dhe besojnë se është pikërisht koncepti i ekzistencës së Zotit, i cili ka krijuar dhe po krijon kaq shumë turbullira në gjithë botën. Në njëren nga fjalimet e mia të mëhershme e kam zënë në gojë një libër i cili është botuar në Britani dhe që është konsideruar si njëri nga publikimet më të mira të kohëve të fundit dhe është shitur shumë para krishtlindjeve. Autori i librit është munduar ta mohojnë ekzistencën e Zotit. Ngjashëm edhe këtu në Gjermani janë duke u folur gjëra absurde kundër Islamit dhe ekzistencës së Zotit.

Kur Papa e vizitoi Gjermaninë, në fjalimin e tij ai gjithashtu u tall me konceptin e Zotit në Islam dhe tha gjëra që njeriu çuditet se si një njeri i rangut të tij, i cili pohon se përpiket për përhapjen e paqes dhe dashurisë në botë, mund të flasë me një gjuhë të tillë. Në atë fjalim që e dha në emër të të ashtuquajturës liri e shprehjes, ai ka përmendur disa gjëra të pakëndshme dhe fyese rreth Islamit dhe rreth Profetit të Shenjtë^{sas}. Këto ditë këtu në Gjermani në teatrot e vendit është duke u shfaqur edhe një dramë për të cilën antifetarët nuk kanë shprehur ndonjë pakënaqësi, madje kanë thënë se është e pranueshme dhe jo vetëm që e kanë lejuar që të shfaqet, por edhe e kanë pëlqyer. Bile edhe disa liderë muslimanë kanë dhënë pëlqimin për shfaqjen e saj.

Në emër të lirisë së shprehjes ata luajnë me ndjenjat e të tjerëve dhe kur të lënduarit protestojnë, këta thonë se ju po e ngritni zërin kundër lirisë së fjalës së lirë, kundër lirisë së Perëndimit. Dhe nëse protestoni kundër lirisë së Perëndimit, atëherë nuk keni të drejtë të jetoni në shoqërinë tonë dhe duhet të ktheheni prapa në vendet tuaja. Ato që vlejnë për të tjerët nuk vlejnë për ta. Për veten e tyre ata kanë ndjenja të thella dhe sipas principeve të tyre ata mund të bëjnë ç'të dëshirojnë dhe të jetojnë si të dojnë, të vishen si të dëshirojnë, por kur një muslimane shihet me shami në kokë, ata protestojnë duke thënë se kjo është e papranueshme.

Fakti është se Perëndimi është duke u larguar me shpejtësi nga feja dhe moralet e larta dhe është duke u zhytur gjithnjë e më shumë në një jetë të shthurur e mëkatnore. Të tillë ishin edhe popujt e së kaluarës që i refuzonin profetët, i përqeshnin dhe s'linin mëkat pa bërë duke ndjellur kështu dënimin Hyjnor. Allahu ka dërguar profetë për t'i udhëzuar njerëzit në rrugë të drejtë dhe për t'i shpëtuar nga vetëshkatërimi. Por shumica e tyre që i mohonin ata (profetët) u bënë pre e dënimit të Allahut. Allahu e ka ruajtur dhe na e ka shpalosur historinë e disa prej tyre dhe i ka përmendur veprat e tyre të shëmtuara. Cilat janë ato vepra të shëmtuara e mëkate të cilat Allahu i ka përmendur në Kur'an e të mos i gjeni edhe ndër këta njerëz. Me gjithë paralajmërimet e profetëve të Allahut, ata nuk hiqnin dorë nga mëkatet e tyre, përveç një numri të vogël të besimtarëve. Ata ishin të zhytur në amoralitet, mashtrime; edhe pse këta nuk mashtrojnë në nivel të ulët me popullin e tyre, por e bëjnë atë në nivel ndërkombëtar me popujt e tjerë; pra të gjitha bëhen edhe këtu. Josinqeriteti, gënjeshtria dhe amoraliteti i kanë arritur shkallët më të larta në këtë kohë.

Te popujt e ndryshëm ishin të theksuara ligësi e mëkate të ndryshme në të cilat ata kishin arritur kufijtë e skajshëm dhe nuk hoqën dorë prej tyre edhe pas shpjegimeve të profetëve. Pra, Allahu, i cili i ka krijuar njerëzit për një qëllim të caktuar, nëse ata nuk e përmbushin atë, natyrisht se do të ndëshkohen. Ky ishte përfundimi i atyre popujve në të kaluarën dhe kështu do të jetë edhe në të ardhmen. Përndryshe, gjeneratat e mëparshme do të kenë të drejtë t'i ankohen Allahut duke i thënë se ne u dënuam si rezultat i mëkateve tona, ndërsa ata që erdhën pas nesh duke i bërë të njëjtat mëkate nuk u dënuan. Pasi që Allahu është sundues suprem, disa njerëz dënohen në këtë botë dhe disa do të dënohen në botën e ardhshme, por sipas praktikës së Allahut njerëzit e tillë sigurisht që nuk do të mund t'i shpëtojnë dënimit të Tij.

Në dramën që është shfaqur është përdhosur nderi i profetëve të Allahut dhe Allahu është paraqitur si i padrejtë. Këta njerëz as që mund ta imagjinojnë sa të mëdha janë fuqitë e Allahut. Allahu ka një ndjenjë të lartë vetrespekti për Vete dhe për të Dërguarit e Tij.

Këta njerëz janë duke e çnderuar dhe përdhosur emrin e Zotit dhe të Profetit të Tij, për të cilin Allahu ka thënë se po të mos ishte për ty, nuk do t'i kisha krijuar tokën dhe qiejt. Allahu nga mëshira e Tij u ka dhënë të mira të panumërta materiale dhe ata ngrejnë akuza kundër të njejtit Zot. Ata po e prejnë degën në të cilën janë ulur. Kjo s'është gjë tjetër pos verbëri e skajshme.

Kam mësuar se njëherë ishte vendosur që të mos shfaqej ajo pjesë që fliste rreth profetëve, por disa ministra dhe njerëz me ndikim thanë “Vazhdoni ta shfaqni dhe ne do të ju mbështesim”. Kam mësuar se këta njerëz janë të zhytur në ligësitë më të mëdha dhe i kanë kaluar të gjithë kufijtë e paturpësisë. Ata japin leje që të përhapen këto ligësi në mënyrë që ligësitë e tyre të mos vihen re. Edhe një gjë e çuditshme në këtë shfaqje është se Hazret Musaja^{as} nuk është paraqitur. Ne nuk themi që edhe ai duhet të ishte paraqitur, sepse ne i respektojmë të gjithë profetët, të cilët janë dërguar nga Allahu, por ne i njohim qëllimet e tyre të liga. Disa mendojnë se me këtë çifutët do të ofendoheshin. Por, çështja nuk mbetet me kaq. Në fakt këtu bëhet fjalë për një komplot mirë të organizuar kundër Islamit. Allahu e mbroftë Islamin kundër të gjitha kompleteve të armiqve të tij.

Sot është detyrë e çdo ahmediani t'u përgjigjet këtyre njerëzve dhe të mundohet ta shpëtoj botën nga dënimi i Allahut. Ju duhet t'u thoni atyre që e quajnë vetën muslimanë, pse po e hidhni vetën tuaj në gropë të zjarrit duke i mbështetur këta njerëz? Ju duhet t'u thoni të krishterëve dhe të tjerëve se feja dhe besimi në Allahun është për të mirën e njerëzimit. Allahu i dërgon profetët për t'i liruar njerëzit nga shtypja dhe jo për t'i shtypur ata. Ejani dhe ne do t'ju tregojmë se Zoti i Islamit përmes atributit të Tij 'rab', përkundër jobesnikërisë suaj ndaj Tij, ju ka bekuar me të mira materiale. Ju duhet t'i ktheheni Atij dhe të pendoheni për mëkatet tuaja dhe ta largoni nga mendja juaj se Allahu mund të bëjë padrejtësi. Allahu i dërgon profetët për të mirën tuaj që t'ju pastrojë nga mëkatet tuaja. E vetmja dëshirë e këtyre profetëve është që njerëzit për të mirën e tyre t'i pasojnë urdhërat e Allahut dhe ta kuptojnë qëllimin e krijimit të tyre, në mënyrë që duke iu afruar Allahut, jo vetëm që do të kenë përfitime materiale, por edhe shpirtërore. Ata nuk i zë gjumi natën duke u merakosur për mirëqenien e njerëzve dhe me dhembje në shpirt luten ditë e natë për ta që ta gjejnë rrugën e drejtë dhe ta fitojnë kënaqësinë e Allahut.

Ky është mësimi i Islamit përmes të cilit arrini shpëtimin dhe kënaqësinë e Allahut. Zotërat e detrave e të erës dhe zotërat e tjerë janë vetëm pjellë e imagjinatës njerëzore. Zoti i Islamit është i vetmi Zot i vërtetë. Fuqia e Tij është e pakufishme dhe Ai e di të dukshmen dhe të padukshmen. Pra, Allahu tregon mëshirë ndaj shërbëtorëve të Tij dhe për shkak të mëshirës së Tij i dërgon këta profetë që t'i shpëtojë shërbëtorët e tij nga kthetrat e djallit. Ata gjithmonë deklarojnë se për këtë nuk kërkojnë ndonjë shpërblim. Ata thonë: Shpërblimi im është tek Zoti im që më ka krijuar. A nuk mendoni pak.

Përhapja e këtij mesazhi është gjithashtu detyrë e çdo ahmediani që t'ia përçojë çdo banori të këtij vendi duke u thënë “O njerëz që e keni harruar Zotin dhe jeni larguar nga Ai, Allahu nga mirësia e Tij ju ka dërguar përfaqësuesin e Profetit të fundit^{saa} Mesihun e Premtuar^{ass} që është shërbëtori i tij besnik. Pra, në vend që të ngreni akuza kundër Islamit

dhe themeluesit të tij dhe të ngreni dyshime rreth ekzistencës së Allahut ose ta deklaroni këtë Zot të mëshirës si një zot shtypës e të padrejtë, ju duhet të vini e të futeni nën mbrojtjen e këtij Zoti, i cili është më i mëshirshëm se ç'janë nënat ndaj fëmijëve të tyre. Për t'i shpëtuar shërbëtorët e Tij nga zjarri, Ai vjen duke vrapuar, me kusht që edhe shërbëtorët e Tij të përpiqen në drejtim të Tij.

Dëgjoni se me çfarë dashurie dhe dashamirësie ai i është drejtuar njerëzve. Mesihu i Premtuar^{ass} thotë: “Detyra me të cilën Allahu më ka dërguar është që ta eliminoj distancën që është krijuar në mes Allahut dhe shërbëtorëve të Tij dhe ta rivendos sinqeritetin e dashurinë në mes tyre dhe duke e shfaqur të vërtetën, t'u jap fund luftrave të fesë dhe ta vendos paqen. Dhe ato vërtetësi shpirtërore që janë fshehur nga sytë e njerëzve, dhe përshtetshmërinë që pothuajse është zhdukur nga faqja e dheut ta shfaq përsëri”. Mesihu i Premtuar^{ass} na ka paisur me thesare të paçmuara të diturisë hyjnore për ta kryer me sukses misionin tonë. Secili ahmedian që ka lidhur bejtin me Mesihun e Premtuar^{ass} e ka për detyrë që ta respektoj bejtin e tij dhe me këtë ndjenjë dhe pasion për njerëzimin, ashtu siç jemi urdhëruar që të dëshirojmë për të tjerët atë që e dëshirojmë për veten tonë. Ne duhet t'ia përqojmë këtë mesazh me të cilin Mesihu i Premtuar^{ass} na ka frymëzuar çdo pjestari të këtij populli.

Mesihu i Premtuar^{ass} thoshte: ‘Për shkak të këtij largimi nga Zoti dhe për shkak të kësaj distance, të cilin të ashtuquajturit liderë fetar e kanë krijuar në mes shërbëtorit dhe Zotit, është detyrë e çdo ahmediani që duke e prezantuar fytyrën e vërtetë të Islamit t'i sjellin këta njerëz para Zotit. Në zemrën e shumicës duhet të krijojmë dashuri për Allahun e për Vulën e Profetëve^{sas} dhe për njerëzit e shenjtë të Allahut dhe të mbjellin dashuri e ndjenja të sinqerta në zemrat e njerëzve në mënyrë që i tërë njerëzimi në vend që të luftojnë me njëri-tjetrin, ta duan dhe ta ndihmojnë njëri-tjetrin dhe që jeta shpirtërore të lulëzojë. Kur do të arrihet kjo edhe ata që tani e akuzojnë Allahun do t'i përulen Atij. Nuk duhet të dëshpërohemi nga veprat e disave, se insha'allah, ahmediati do të shpërndahet ndër këta njerëz.

Shumë nga ahmedianët gjermanë ndjehen të turpëruar për qëndrimin jo të drejtë të bashkëkombasve të tyre, por insha'allah në të ardhmen qindra mijëra e miliona ahmedianë do të ndjejnë keqardhje për konceptin e gabuar të popullit të tyre në të kaluarën. Populli gjerman është një komb praktik dhe insha'allah, nëse sot ahmedianët do ta bëjnë mirë detyrën e tyre të predikimit, ky popull do të bëjë një ndryshim revolucionar në veten e tyre. Hazret Musleh Maud, Kalifi i dytë i Mesihut të Premtuar^{ass} ka thënë një herë se karakteri i popullit gjerman është shumë i lartë. Ata, pas shkatërrimit, e rindërtuan vendin e tyre shumë shpejt. Me këtë shpirt të gjallë, kombi gjerman do ta pranoj Islamit, mësimi i të cilit është ngritja e moralit. Prandaj, detyra jonë është që ta shpërndajmë këtë mesazh. Por, ende shumë ka për t'u bërë.

Literatura që keni në dispozicion duhet shpërndarë. Ju duhet t'i përcillni nevojat e kohës dhe të botoni literaturë të re që u përgjigjet këtyre nevojave. Në fakt këto pyetje që ngrihen sot nuk janë të reja. Këto janë pyetje që janë ngritur edhe në të kaluarën dhe përgjigjet gjenden të shkruara dhe krejt çka duhet të bëni është që t'ua shpërndani njerëzve ato. Të gjithë anëtarët, burra, gra, pleq, të rinj e të reja duhet t'i mbajnë afër

vetes këto libra e fletushka. Secili ahmedian duhet të mundohet ta informoj çdo gjerman. Në ditët tona edhe interneti është një medium mjaft efektiv, i cili mund të shfrytëzohet për përhapjen e mesazhit. Shkoni te çdo anëtar parlamenti, te çdo redaktor gazete, te çdo lider dhe te çdo njeri i shkolluar, që t'ua sqaroni kuptimin e vërtetë të Islamit.

Në një njoftim që e kishte botuar Mesihu i Premtuar^{ass} në kohën e tij shkruante se unë do ta çoj mesazhin tim gjithandej ku posta mund të arrij. Më tutje ai i porosiste anëtarët e Xhematit që të ngrihen e të përpiqen për botimin e Kuranit të Shenjtë në gjuhë të ndryshme. Në të gjitha Vendet e Perëndimit ka shumë zemra të singerta që janë duke ju pritur. Allahu do ta shpërblejë mundin dhe përpjekjet tuaja. A nuk i dëgjoni thirrjet e këtyre njerëzve? A nuk ju kanë arritur zërat e tyre? A jeni sëmure apo përtacia juaj është shndërruar në një sëmurdje të brendshme dhe u ka bërë t'i harroni mësimet e Allahut dhe të Dërguarit të Tij? O njerëz! Ngehuni, ngjeshni armët dhe nisuni për t'i çliruar të burgosurit. Cilat janë armët e kohës sonë?. Ato armë janë logjika dhe argumentet logjike. Largoni, pra, me argumente logjike dyshimet e tyre. Të gjitha këto shpikje të reja janë në shërbim të misionit tuaj.

Unë u them gjermanëve që Allahu ju ka dhënë juve një shans që t'i bashkangjiteni islamit të vërtetë dhe të futeni në Xhematin Ahmedia. Ndërsa ahmedianëve u them mos i harroni porosinë e Mesihut të Premtuar^{ass} dhe veproni sipas tyre dhe tani në këtë kohë, më shumë se më parë me pasion dhe me ndjenja dashamirësie ju duhet t'a përçoni mesazhin e Islamit dhe Ahmediatit të bashkëvendësuarit tuaj, në mënyrë që edhe ata ta njohur Zotin e vërtetë. Mesihu i Premtuar^{ass} thotë se banorët e Amerikës dhe të Evropës kanë të drejtë të mos e pranojnë fenë për derisa ne nuk e prezentojmë atë me argumente logjike.

Të botosh disa mijëra broshura dhe të mendosh se do të mjaftojnë për miliona njerëz nuk është mendim i drejtë. Natyrisht që mundësitë tona janë të kufizuara, por të gjitha mjetet që janë në dispozicionin tuaj duhet t'i përdorni ashtu si duhet. Ju po i kushtoni vëmendje një rës gjë duke e harruar tjetrën. Jo vetëm përreth qendrave të Xhematit, por në çdo rajon dhe në çdo qytet dhe në çdo vend ku ahmedianët jetojnë apo nuk jetojnë, duhet të shpërndahen broshura dhe literaturë. Siç e përmenda edhe më parë edhe mediat elektronike duhet të përdoren për këtë qëllim. Përgjigjet ndaj fjalimit të Papës janë përgaditur dhe me sa e di unë u janë dërguar edhe juve, në mënyrë që t'i përktheni e t'i publikoni në gjuhën lokale. Ato duhet t'i dërgohen Papës dhe çdo njeriu të shkolluar këtu, që ta dinë se kush është Zoti^{xhh} dhe cili është statusi i vërtetë i Profetit të Shenjtë^{sas} dhe cili është shembulli i tij i shkëlqyer. Atë që po e akuzojnë se është liderë i terroristëve, ai në të vërtetë është personifikim i mëshirës. Atij i është dhënë titulli 'Rahmetulil-alemiin' - mëshirë për të gjithë njerëzimin, ndershmërinë dhe karakterin e të cilit e çmonin lartë edhe vetë armiqtë e tij. Është përgjegjësi e secilit prej jush që ta përçojë këtë mesazh në rrethin e tij e më gjerë dhe të përpiqeni sinqerisht dhe me tërë qenien tuaj në shërbim të çështjes së Islamit. Suksesi është në dorën e Zotit, por çdo mundësi që Allahu ju ka dhënë ju duhet ta përdorni.

Është e domosdoshme që për të pasur sukses në predikimet tuaja, ju duhet të jeni të angazhuara në punë të mira dhe të jeni të dëgjueshëm ndaj administratës së Xhematit. Vetëm atëherë do të keni sukses në përhapjen e mesazhit të Islamit dhe vetëm atëherë

mesazhi juaj do të ketë efekt, sepse do të jetë i bekuar nga Allahu. Allahu i bekon veprat e atyre që kanë kualitete të tilla. Kurani thotë: **‘Wa man ahsana kauulan mimman daa-a ilall-llaahi wa mina saalihan wa kala innanii minal muslimiin’** - “Kush mund të jetë më i mirë në fjalë se ai i cili thërret drejt Allahut dhe bënë vepra të mira dhe thotë se unë me të vërtetë jam ndër të bindurit (muslimanët)”. Pra, së pari ju duhet vetë ta praktikoni mësimin që e predikoni. Duhet t’i kushtoni vëmendje adhurimit të Allahut dhe vetëm atëherë do të duken rezultatet, sepse thirrja drejt Allahut, predikimet dhe përpjekjet tuaja nuk mund të jenë të suksesshme për deri sa të mos e kenë bekimin e Allahut; dhe për ta patur bekimin e Tij, ju sinqerisht duhet t’i bindeni Atij dhe t’i kryeni të gjitha detyrimet ndaj Tij. Është gjithashtu e nevojshme që t’i kryeni edhe obligimet tuaja ndaj krijesave të Allahut, qofshin ata të afërmit, fqinjët apo të tjerët. Kushdo që ka nevojë për ndihmë, ju duhet ta ndihmoni.

Por, nëse prindërit e atij që thirret në rrugën e Allahut janë të pakënkur me të, gruaja dhe fëmijët kanë frikë prej tij, (ndërsa gratë për shkak të përcjelljes së modës u shkaktojnë kokëqarje burrave të tyre), dhe nëse fqinjët janë të bezdisur prej tyre, atëherë si mund të shpresohet për sukses nga një “predikues” i tillë. Ju duhet të jeni shembull mirësie për të tjerët. Nëse do të tregoni morale të larta, Allahu do t’i bekoj përpjekjet tuaja, sepse ata që i kryejnë detyrimet e tyre ndaj Allahut dhe janë shembull i mirë, për shkak të kësaj ata do t’i meritojnë bekimet e Allahut.

Duhet ta dini se Allahu i ka premtuar Mesihut të Tij: *“Unë do të të bëj ty fitimtar. Kjo fitore do të jetë në Evropë dhe në Afrikë e Azi; edhe në Amerikë gjithashtu, insha’allah. Edhe banorët e ishujve nuk do të jenë të privuar nga këto bekime”*. Por, është detyra juaj që duke u bërë tërësisht të Allahut, duke treguar bindje të plotë ndaj Tij dhe duke bërë vepra të mira ta shpërndani këtë mesazh në mënyrë që të mund t’i pranoni ato bekime që i janë premtuar Mesihut të Premtuar^{ass} dhe pasuesve të tij të vërtetë.

Mesihu i Premtuar^{ass} rreth përhapjes së mesazhit në Evropë dhe Amerikë ka thënë: “E di se nuk do të kaloj shumë kohë, kur shumë prej tyre do të shtyhen nga ndihma e Allahut dhe do të futen nën mbrojtjen e kësaj feje të mrekullueshme, e cila i dhuron njeriut diturinë dhe bindjen e vërtetë. Këtë nuk po e them nga vetja, porse Allahu më ka informuar me anë të revelatës Hyjnore dhe kjo, insha’allah, do të arrihet dhe Allahu do t’i sjellë të gjithë natyrëmirët në prehërin e Islamit. Vendimi përfundimtar është në dorën e Allahut, por ju duhet ta mposhtni përtacinë që e keni lejuar të fusë rrënjë në veten tuaj në mënyrë që të meritojnë bekimet e Allahut. Bëhuni ndër ata që janë më të mirët në fjalë dhe dërgojani mesazhin e shpëtimit çdo të riu e të vjetri, sepse ky është shërbimi më i madh që mund t’ia bëni Islamit dhe ky është shërbimi më i madh që mund t’ia bëni njerëzimit”. Allahu na mundësoftë të gjithëve të bëjmë kështu. Amin!

Note: This is an Albanian translation of Hazoor’s Khutba of **22 December 2006** held in ‘Baitus-Subuh’ - Frankfurt am Main, Germany. The main topic of this Khutba is the response to the anti islamik attacks of Pope and of the media in the West. This translation has been prepared by the members of Kosovo Jam’aat.